



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 30.01.2023, Nr. 09-MA/01-5781



Në bazë të nenit 64 pika 1, 68 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Udhëzimit Administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ nr. 34/2014 funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtori për Arsim në Drenas, shpallë:

K O N K U R S

1. SHFMU "Ali Gashi", Çikatovë e Re dhe ShFMU „Xheladin Gashi-Plaku” ,Komoran,
- Një Psikolog shkollor,
2. SHFMU" Rasim Këçina", Drenas dhe ShFMU" Gani Syla", Poklek I Ri
- Një Psikolog shkollor,
3. IAAP "Fehmi Lladrovci", Drenas
- Një Psikolog shkollor
4. SHML" Gjergj Kastrioti -Skenderbeu", Drenas
- Një Psikolog shkollor

Punët dhe detyrat për Psikolog shkollor

- Vendimmarrja e bazuar në të dhënat e mbledhura dhe mire llogaritura (orienton format e aktiviteteve shkollore , ndihmon arritjen e synimeve të sistemit shkollor etj) .
- Komunikimi ndërpersonal , bashkëpunimi dhe konsultimi-këshillimi (konsultimet me prindërit , kujdestarët , profesorët , administratorët dhe profesionistët e tjerë në shkollë , për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve që nxënësit i kanë në klasë, shkollë, familje)
- Dhënia e instruksioneve efektive , ndihmës për zhvillimin kognitiv dhe akademikë (ndihmojnë kujdestarët e klasave dhe personelin për të zhvilluar strategji akademike për të gjithë nxënësit , për të aplikuar në praktikë teoritë e të mësuarit kognitiv etj).

- Socializimi dhe zhvillimi i të qenurit kompetent në jetë. (Ofronë konsultime individuale , grupe , klasore , familjare etj , për të ndihmuar performancën sociale , emocionale dhe akademike) .
- Diversiteti në zhvillim dhe mësim(bëjnë analizim të “ diferencave individuale “ gjë që ju mundëson atyre të zhvillojnë dhe implementojnë intervenime bazuar në karakteristikat e personit , familjes , sistemit social etj).
- Struktura , organizimi dhe klima në shkollë(bashkëpunojn me akteret e shkollës në dizajnimin dhe participimin e nxënësve në grupet mbështetëse/ndihmëse, koordinimin e këtyre grupeve , përmirësimin e klimës sociale në shkollë etj) .
- Parandalimi dhe intervenimi në kriza, promovimi i shëndetit dhe mirëqenies(bashkëpunojnë ngushtë me institucione profesionale të këtyre fushave , me qëllim dizajnimin e programeve të ndryshme të integruara).
- Etika dhe zhvillimi profesional(pranojnë detyrat e tyre me nivelin më të lartë të përgjegjësisë , etikës dhe profesionalizmit, ruajn me shumë konfidencë qështjet e nevojshme.Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve

Kushtet: Për vendet e punës, në këtë nivel (Diplomë Bachelor, MA- në Psikologji shkollore dhe këshillim) kandidatët duhet ta kenë të kryer drejtimi përkatës sipas Normativit 05/2021, 34/2014 –MASHT.

Zgjedhja e kandidatëve për Psikolog shkollor do të bëhet në bazë të të Udhëzimit Administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ nr. 34/2014 funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë. Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas Udhëzimit administrativ nr. 05/2021 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. **Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin :**

- Kopja e vërtetuar e diplomës origjinale,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikata origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër se gjashtë(6) muaji
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni)

- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr 10, 12
- Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm për një(1) institucion, gjegjësisht për një(1) pozitë në njëren prej pikave(1.2.3)

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHTI.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.

Rezultatet e konkursit do të shpallen në web-faqe të Komunës së Drenasit.

Dokumentacioni nuk kthehet.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **01.03.2023** deri **15.03.2023**.

Njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen zyrtare të Komunës së Drenasit dhe në linkun:

<https://konkursi.rks-gov.net>.

Drenas,

Më:30.01.2023


Drejtor për Arsim
Muhamet Gjoka